

Në udhën e traditës më të mirë të shtypit

Ka ditë të shënuara që kanë zënë vend në kujtesën e kombit. Që lidhen me ngjarje të rëndësishme historike. Siç ka edhe ditë të tjera që meritojnë të kenë një vend në jetën qytetare. Një ditë e tillë do të mbetet edhe kjo e sotmja, që solli në jetë këtë gazetë të re me këtë emër tepër shprehës.

Lajmëtari do të jetë një gazetë e Beratit dhe për Beratin. Kjo gazetë do të ndjekë traditat më të mira demokratike të shtypit baratas, ato tradita që ushqyen themeluesit e shtypit të qytetit tonë, midis të cilëve përmendim: Jani Vruhon, Sotir Kolean, Ferit Vokopolën, Islam Vrionin, Abdullah Ferhatin, Vexhi Buharanë së bashku dhe me shumë gazetarë që bashkëpunuan me ta apo që u morën me gazetari në vitet e mëvonshme.

Në këtë gazetë çdo qytetar do të gjejë Beratin, historinë, kulturën, jetën e tij politike, problemet që e shqetësojnë. Kjo gazetë do të jetë një nga dritaret e hapura nga do të shpërndahet drita e përparimit dhe e mirëkuptimit qytetar.

Gazeta do të karakterizohet nga kultura qytetare, kultura gjuhësore, kultura e shkrimeve, duke mbetur thellësisht e pavaruar. Ajo pret bashkëpunimin e çdo qytetari. Është e hapur për të gjithë.

Ju mirëpresim!

Agim Mehqemeja

Protesta ... reagim si popull

Në ka një popull të stresuar në Europë, ky është populli shqiptar. Në historinë e tij ende nuk ia ka arritur të ndërtojë institucione në shërbim të tij, por ka ngritur institucione që e mu-ndojnë, e lodhin e stresojnë çdo ditë.

Diçka që përsëritet çdo ditë a është ngjarje?

Përditë shqiptarët kthehen në shtëpi dhe në vend të shlodhen, lodhen edhe më tepër. Nuk ka as drita. as ujë. Shajnë, mallkojnë, zihen me familjarët dhe shpesh vrapojnë drejt telefonit. Duan të derdhnin tërë zemërimin tek shteti. Formojnë numrin e elektrikut 32350. Matanë telit dëgjohet sinjali pip ... pip ... pip. Shteti si dinak dhe njohës i psikologjisë sonë, e ka prerë komunikimin me ne. E di mirë se ne protestojmë fort në telefon, pa e thënë as emrin dhe fap ... na e pret zërin. Temperatura ka shkuar 40 gradë. Nuk ka një gotë uji të ftohtë. Nuk mund të takosh një ventilator. As që mund të bëhet fjalë për të ngrënë një drekë të ngrohtë si njeri. Të vetmin shans proteste shteti e ka prerë. Dhe shqiptarët u kthehen familjarëve. Zihen e grihen me ta kot së koti. Shteti hesht si ai telefoni në cep të dhomës.

Shqiptarët kanë lindur për t'i nxirë jetën njëri - tjetrit.

Ndërsa udhëtonim me një furgon, shoferi mori një pasagjer jashtë vendeve. "Futu aty pas. Shtërngohuni ca se ky do të zbresë në Lushnje". Të gjithë heshtën. Një nga pasa-gjerët që udhëtonte për Tiranë, i thirri shoferit të ndalonte. "Urdhëro lekët për rrugën deri këtu", i tha. Po zbres unë. Do të gjej një furgon tjetër. Ai zbriti, por askush nga udhëtarët e tjerë nuk e mbështeti. Të gjithë heshtën, me përjashtim të shoferit që, kur pa se protestuesi u largua, i këputi një të sharë. Sidoqoftë qe një ogur i mirë. Ende prote-stojmë, pra, reagojnë si popull.

Fyerje në dritë të diellit

Prapa Ministrisë së Jashtme janë dy rreshta me njerëz që kërkojnë të marrin vulat e kësaj Ministrie. Kalojnë orë dhe radha nuk lëviz. Një sekser, 26- 27- vjeçar, me një zinxhir të florinjte me të cilin mund të bëjë zap një qen, i fuste njerëzit pa radhë dhe u merrte nga njëzet mijë lekë të vjetër. Një vajzë e brishtë me syze, murgeshë, tepër e re-voltuar e kapi djaloshin prej zinxhiri dhe me një shqipe të çalë, i kërkoi të hapte rrugën drejt hyrjes. Bisha, me shputën e dorës së djathtë, e goditi aq fort në fytyrë sa iu thyen syzet dhe riga gjaku i mbuluan fytyrën. Po-lici, bashkëpunëtor i bishës ktheu kurrizin dhe u largua. "Ju burra s'jeni", iu drejtua mu-rgesha të dy krahëve, në të majtë dhe në të djathtë. Murgesha e brishtë italiane, edhe pse murgeshë, dhe pse prej shumë vitesh në Shqipëri, ende e ruante sensin e protestës.

Pse protestojnë parizienët?!

Dikush nuk e spjegonte dot pse parizienët protestonin për një ngjarje që ndodhte në Kore, a në Kinë, a në Afrikë. Dikush tjetër i spjegoi se ata e ndjejnë padrejtësinë mijëra kilometra larg dhe shqetësohen. Nëse nuk protestojnë ato mijëra kilometra kthehen në qindra ..., dhjetëra ... dhe padrejtësia të vihet si kular në qafë. Atëherë do të jetë vonë për protestë.

Gent Panariti

Dekorimi i dhunshëm i jetës sonë

Ka kohë që në Berat, por jo vetëm në Berat, ka një përkujdesje maksimale për të evokuar të kaluarën jo shumë të largët sipas një kriteri tipik ideologjik, për fat të keq ende të pranishëm në jetën tonë. Në qytet ka filluar dekorimi i fa-sadave, lulishteve, mureve me pllaka për-kujtimore pas të cilave ajo që mungon më së shumti është ngjarja.

”Kjo shtëpi ka qenë bazë e luftës”, ”Këtu ka kaluar Brigada x Sulmuese”, ”Këtu është strehuar shoku Z”, deri tek një pllakë që të bën edhe të qeshësh :”Këtu u rrëmbye (u vodh- shënimi im, Y.H), nga njësitë gueril shaptilografi”.

Këto pllaka nuk kanë të sosur në qytet, në fshat, pra në të gjithë Shqipërinë.

Nga lind gjithë kjo përkujdesje për t’na sjellë të shkuarën e afërt, në mjaft raste edhe të gënjeshtërt, tani në shekullin e internetit?

C’është ky dekorim i jetës sonë ?

Herë- herë Shqipëria i ngjan të famshmit Haxhi Qamil, që, në një kohë marrëzie totale,(dhe këto kohëra nuk janë të rralla në jetën e shqiptarëve) u vetëdekorua gjysmë gjeneral e gjysmë Robinhud. (Veshi një xhakëtë gjenerali evropë, vuri në kokë një kallpak pashai turk dhe poshtë mbante brekushet e fshatarit tiranas.) Dhe u vu në kërkim të Babës. Pas e ndiqnin mijëra e mijëra njerëz më të marrë se vetë marrëzia.

Edhe sot me keqardhje vëmë re se Shqipëria po dekorohet si e tillë, por nuk jam fort i sigurtë nëse vërtetë Shqipëria, ashtu si Haxhi Qamili, është në kërkim të Babës.

Pllakat përkujtimore, ku flitet për beteja që nuk janë zhvilluar kurrë, po mbushin çdo rrëpirë fshati, çdo rrugë dhish, ku prej vitesh nuk kalon njeri.Lapidarë dhe monumente i ngrihen një kohe kur përçarja dhe urrejtja midis shqiptarëve arriti kulmin. C’është ky vrapim në të shkuarën?

Njihet thënia se kush përtyp të shkuarën, nuk ka as të sotme, as të ardhme.

Po pse bëhet e gjithë kjo? Natyrisht jo thjesht për të ruajtur traditën, vlerat e saj. Nëse do të fiksohej e kalura me vlerat e saj tashmë të provuara, do të qe një punë e lavdërueshme. Por e kaluara, tradita, civilizimi për dekoratorët tanë të mëngjër nis më 1941. Cinizmi, propaganda, dhuna dekorative janë të pashembullta në një shoqëri që trumbetohet si pluraliste, e lirë e demokratike. Sot mund të thuhet se Shqipëria është vendi më i ideologjizuar në Evropë.

Poeti i madh nobelist Josif Brodski, një ditë të bukur, duke dëgjuar një fjalim të sekretarit të partisë komuniste në fshatin ku e kishin syrgjynosur, befas këputet e bie pa ndjenja. Miqtë e tij të alarmuar e çojnë në spital, ku poeti i jashtëzakonshëm i nënshtrohet një egzaminimi të kujdesshëm. Në fund mjekët erdhën në përfundimin se Brodski i madh nuk kishte asnjë gjë. Kishte rënë pa ndjenja thjesht nga alergjia që i shkaktuan mendimet e cekta, nonsenset politike, marrëzitë që nxirrte nga goja sekretari i helmuar ideologjikisht i partisë.

Natyrisht, një shpirti të lirë, një gjeniu si Josif Brodski i bënin reaksion pallavrat.

Ka dashur Zoti që ne të mos jemi aq sqimtarë dhe të ndjeshëm sa Brodski i madh, në të kundërt përfytyroni se çfarë do të ndodhte kur të dëgjonim lajmet në tv, kur të lexonim pllakat, kur të dëgjonim fjalimet nëpër festa apo në përkujtim të ngjarjeve që s’ndodhën kurrë, kur të dëgjonim ”fjalimet” e ca ofiqarëve tanë në tribuna e në institucione publike, kur të dëgjonim parlamentin e mbushur me ”qëndrestarë”. Të gjithë do të binim e do të ndodhte një katastrofë e madhe humanitare.

Po pse bëhet e gjithë kjo?

Jo thjesht për arsye ideologjike.

Europa Lindore ka kohë që është çliruar nga këto marrëzi. Ajo kërkon të integrohet realisht në Perëndim, ku idiotësitë ideologjike nuk pinë ujë.

Ka një pragmatizëm në gjithë këtë marrëzi në Shqipërinë tonë të dashur (siç thotë shpesh një politikan). Pragmatizmi qëndron në faktin e dekorimit të mjedisit me një ngjyrë politike, thjesht për të mbajtur gjatë pushtetin.

Bie fjala, tek muri i ndërtesës ku shkruhet se këtu u vodh një makinë shkrimi a diçka e tillë në vitin 1991 u vendos selia e degës së partisë së parë opozitare në Shqipëri, Partisë Demokratike. Ky fakt është domethënës për një shoqëri që vinte nga diktatura, për një shoqëri që prej dekadash nuk e njihte pluralizmin. Pra, krijimi i degës së PD-së është ngjarje, shumë më domethënëse se vjedhja e një makine shkrimi a diçkaje të tillë. Por as PD, as pushteti lokal i saj nuk bëri marrëzinë të vendoste pllaka përkujtimore. Ose aty ku ka qenë rojtorja publike mund të vendosej një pllakë, ku të njoftohej vërtetë për një ngjarje: ”Këtu ka punuar si faturist poeti, studjuesi dhe përkthyesi i talentuar Vexhi Buharaja.”

Berati është një qytet emblemantik i qytetërimit shqiptar. Kur vijnë vizitorët dhe lexojnë pllakat ”e famshme”, stepen. Natyrisht, nëse nuk do të vuanin pushtetarët tanë nga epilepsia ideologjike, vizitorët mund të lexonin: ”Këtu në vitin 1281, pas dhjetë muaj rrethimi e qëndrese qytetarët e Beratit thyen anzhuinët. Në nderim të asaj qëndrese u ngrit kisha e Shën Mëri Vllahernës.” Ose : ”Këtu u gjet Epitafi i Gllavenicës, vepër arti e vitit 1373.” Ose: ”Këtu ranë trimërisht në betejë kundër turqve 500 luftëtarë italianë të dërguar nga Alfonsi V i Aragonës nën komandën e Raimondo Orsatës në ndihmë të Skënderbeut.” Ose: ”Këtu u ruajtën Kodikët e famshëm të Beratit.”

Apo më poshtë në buzë të lumit mund të qëndronte fare mirë një pllakë e tillë përkujtimore: ”Këtu poeti i shquar Nezim Berati, Anakreonti i Shqipërisë (siç e quajti Hani- shënimi im, Y.H) më 1735 u ndesh në një garë poetike dhe fitoi me Mulla Alinë.”

Kuptohet se këto pllaka e mjaft të tjera do të ishin mjaft domethënëse.

Dekorimi metaforik apo i drejtpërdrejtë i jetës sonë ndjek jo thjesht një traditë të shëmtuar. Në ditën e festës kombëtare, më 28 nëntor po shëtisja me mikun tim A. P, me formim të majtë dhe e pyeta se çfarë përfaqësonin flamujt e kuq që digjnin gjithë qytetin, krahas fare pak flamujve kuq e zi që valëviteshin në atë ditë të shënuar. Miku im nuk qe në gjendje të më jepte asnjë lloj shpjegimi. Ndoshta thjesht për traditë. Ndoshta thjesht si zburim.Ende, në çdo festë, bëhet përskuqja e qytetit.(Lexues

i nderuar mund ta vëresh këtë fakt në festën më të afërt). Një marrëzi e përafërt kishte ndodhur jo në përmasa të tilla dhe jo në një hark të tillë kohor para krishtlindjeve të vitit 1996. Cedra para këshillit të rrethit që zbukuroi krahas dekoracioneve të tjera edhe me tollobmace të kaltra ku që stamposur logoja e PD. I thirra zyrtarit të asaj kohe dhe i kërkova të më spjegonte marrëzinë (Qeshë i zgjedhur në këshillin e bashkisë si përfaqësues i PD-së). Brenda pak minutave cedra u çlirua nga tollombacet politike. U ndjeva i çliruar dhe mendova se do të që mrekulli sikur qytetarët e Beratit të mos e kishin vënë re atë lajthitje. Po dekorimi i dhunshëm i jetës sonë nuk ndalet këtu. Ai vazhdon në salla mbledhjesh, ku nuk mungojnë edhe zyrtarë dhe politikanë të lartë që sapo janë ndarë me personalitete evropiane e amerikane ku kanë ironizuar e qeshur me marrëzinë diktatoriale. Janë hipokritë apo pragmatistë?

Në një sallë mbledhje qene mbledhur veteranët e luftës. Kështu të paktën u lajmërua nga folsi i tv-së. Për çudi në sallë kishte a s'kishte ndonjë 80 vjeçar. Qenë fëmijë kopshti deri tek 50-60 vjeçarë. Këta janë veteranët e famshëm? Thuhet, por unë nuk dua ta besoj, se po ngrihen organizata veteranësh në lagje, në shkolla e deri në kopshte. Po harxhohen miliona për të vendosur lapidarë, pllaka pë-rkujtimore, monumente, skulptura heronjesh të rreme, memorialë në zona pa asnjë banor, në fshatra ku jetojnë 2-3 shtëpi. Ndërkohë gjimnazistët nuk kanë pajisje për të realizuar orët e mësimin, nuk kanë një fotokopjues, ku të fotokopjojnë testet e shumtë, nuk kanë kompjutera, nuk kanë internet, nuk kanë salla argëtuese e kulturore.

"Hani gjeneralët!", -përfundonte një barcoletë e treguar fshehur në kohën e diktaturës, ku protagonistin mburrej me të kaluarën "e lavdishme" dhe gjeneralët e shumtë që kishte nxjerrë fshati i tij i mjerë.

E gjitha kjo është një marrëzi e madhe në kurriz të komunitetit. Paratë Europa dhe Amerika i sjell për të përmirësuar jetën e shqiptarëve, jo për të shtuar logot e ekstremit të majtë.

Në Shqipëri logot e diktaturës janë kudo të pranishme : bunkerë, pallate si guva, rrugë të ngushta, mungesa e ujit, mungesa e dritave, sherret politike, mjerimi shpirtëror e mjerimi ekonomik, njeriu i ri përbindësh, ("Në Shqipëri pashë dhëmbë të prishur, këpucë të zeza dhe sy të sëmurë epshorë", -shkruante në një gazetë perëndimore një reportere e re në vitet 80-të.) Kur kemi kaq e kaq simbole e logo të diktaturës, pse duhet të shtojmë edhe ca të tjerë?!

E kaluara na ka kapur prej duarësh, prej këmbësh, dhe ç'është më e vajtueshmja prej koke. Natyrisht, s'kemi pse ankohemi hiç, kur Euvropa na e vë kufirin tek thana dhe prej kohësh e ka thënë për ata që kanë veshë: "Hani gjeneralët!"

Yzedin Hima

Politika "e madhe" dhe "urtësia" e popullit

Politika "e madhe" bëhet vetëm në Tiranë. Këtë politikë e bëjnë partitë dhe përfaqësuesit e tyre nëpër forumet partiake, nëpër debate televizive, vecanërisht, në seancat e Kuvendit Popullor.

Kjo politikë ka zënë ekranet, debatet televizive, fjalën e opinionistëve, faqet e shtypit dhe median në përgjithësi.

Po populli ç'bën?

Ai vetëm sheh, vetëm dëgjon, vetëm shfryn ndonjë mllef nëpër kafene, para ndonjë gote, në bisedat para kioskave të gazetave. Dhe me kaq e quan të kryer detyrën e tij qytetare.

Po partitë nëpër rrethe ç'pozicion mbajnë?

Ato mbeten në pritje të udhëzimeve.

Gladiatorët e majtë kanë dalë në arenë dhe me shpatat prej kartoni po ndeshen "për jetë a vdekje".

Dhe populli hesht, dhe populli qesh

Opozita bën sehir si spektatore nëpër shkallët e arenës. Partitë e vogla, brenda saj, kanë një shqetësim tjetër: të rregullojnë ndonjë nen të ligjit të zgjedhjeve. Nuk i shqetëson fitorja e së djathtës. Ka ndonjë kryetar partie që nxiton të shpallet kandidatë për kryetar bashkie në kryeqytet. Edhe pse e ka të sigurtë humbjen. Po kjo s'ka shumë rëndësi për të. Mjafton të humbasë me të edhe kandidati i partisë më të madhe, ngaqë i duket se ia ka patur me të pabesë. Si duket e kanë harruar se nga kjo parti e madhe, në zgjedhjet e fundit, përfituan më shumë nga ç'u takonte. Sa ngritën edhe grupe parlamentare. Populli vuan dhe hesht. Edhe partitë që s'duhet të heshtin, edhe ato heshtin. Ngrihen në demonstratë të burgosurit politikë për të kërkuar të drejtat e tyre. Po ata në protestën e tyre mbeten të vetëm. Me ta bashkohet edhe ndonjë politikan. Partitë opozitare e ngrejnë zërin edhe në seancat e Kuvendit Popullor. Po kjo është pak. Shumë pak. Populli hesht. Se ai ka heshtur edhe kur s'ka patur drita, edhe kur s'ka patur ujë edhe kur s'ka patur..Ç'i duhet të merakoset për të tjerët? Futen disa gra bashkë me fëmijët e tyre në grevë urie. Përsëri populli hesht. Nuk mendon se një ditë edhe atij mund t'i bjerë mbi kokë i njëjti hall.

Po nga t'ia mbaj i ziu popull? Punët e politikës ia ka lënë partive politike. Po ato heshtin. Nuk duan turbullira. Po pse në Malin e Zi, para disa vjetësh, ngaqë në treg për dy-tri ditë mungoi pluhuri larës, u hodhën të gjithë në demonstrata të fuqishme? Pse, kur shtetet organizojnë samite, populli i vendit pritës ngrihet në revolta? Se ata ka kush i drejton. Pse populli ynë është kaq "i urtë", kur ka politikanë që luajnë me fatet e atdheut të tyre (le të kujtojmë historinë e Bishtit të Pallës)? Se nuk ka kush i drejton. Populli pret ndryshime. Ju takon juve, politikanë, ta përmendni këtë popull "të urtë", që të zgjohet, që nesër të marrë pjesë me ju në ndryshimet e pritshme!

Le të shpresojmë.

Kapelet allafrenga të politikanëve allaturka

Me dhjetra herë në këta vite tra-nzicioni kemi përsëritur refrenin migjenian: të lindet njeriu! Në pritje të shpëtimtarit kemi pritur më kot që kosherja e politikës shqiptare të prodhojë mjalutin; të gjitha gjasat janë të dështuara për një gjë të tillë, sepse gjallesat krahëflurore që rrëken ta prodhojë atë, nuk janë bletë, por arrëza. Arrëza dënglamëdha që të shurdhojnë veshët me zukumata e tyre të besdishme e të kota.

Politikanët shqiptarë, thënë ndryshe, sifeti i dështakëve arrogantë të politikës shqiptare, tra-shëgon nga e djeshmja gjithë idolatrinë ham-ngjitëse për shefat, idolatri që e kanë injektuar me shiringë tek vartësit e tyre më të vegjël, sejmenët injorantë të provincës, trumcakët dhe harabelët e vegjël të nëpunësisë shtetërore e gjer tek ai bariu i malit që mallëngjehet nga broçkullitjet e Fatos Nanos dhe mërmërit: nxëk, nxëk, sa i mënçur është qerrata!

Sifeti i pakorrigjueshëm i politikanëve shqiptarë është ajo masa e madhe e mishit në Parlamentin Shqiptar, është një lloj mulliri prej kockash e muskuajsh që prodhon vetëm fjalë, fjalë. Ai e di fare mirë se për të ruajtur karrigen e kuqe (atë kalë revanlli që të shtyp me patkonj), i duhen miqtë, tarafet, sejmenët e provincës, thjesht, pra, i duhet klani. E kini vënë re kur ndonjë nga shefat e mëdhenj të partisë vjen në provincë: sejmenëve injorantë iu qeshin sytë, u kruhet trupi, dikur nga kënaqësia do t'iu mbijnë pupla, iu bëhen faqet paparunë dhe dhëntë Zoti që shefi i madh të mos thotë ndonjë fjalë, e kapin me putra, e çukërmojnë, i marrin erë, dhe e varin si hajmali në xhepin, ku mbajnë teserën e partisë. Dhe pastaj me këtë hajmali nisin luftën e shenjtë ideologjike kundër xanxarëve dhe rebelëve opozitarë.

Xhinsi harramsëz i politikanëve shqiptarë bën të gjitha grimaset dhe gjestet e nevojshme për t'iu dukur allafrenfa, shqipton tek -tek ndonjë frazë anglisht, flet për koncertet e rrokut dhe modën e Parisit, por, sapo i paraqitet rasti, dëndet me mish qengji në orgjitë festive partizane nëpër krahina, pi raki vënçe, dhe ia merr këngës për komandantin legjendar. E.H (Eh!) Këta xhagajdhurë e kokëtrashë e harrojnë se Europa si jep paratë për të mëkëmbur enverizmin e stalininizin, por për ta mbrothësuar sadopak këtë popull të vobektë e gjynahqar. Xhinsi i këtij lloji, duke qenë pa ide dhe vizione, ka prorje të çukisë në bistakun e tharë të rrushit kokërrzi të së shkuarës, të jetojë me lavdinë e paqenë të saj, të mburrë patriotizmin, besën e trimërinë, pra, të jetojë në mënyrë folklorike. Fakti që në shumë vende vazhdojnë të ngrihen lapidarë, tregon zellin babëzites të këtyre njerëzve për t'iu ngopur të tjerët me llomka të majme mermeri. Po, po, llomka të tilla të tilla që të kujtojnë djathin e napave të stanarëve. Politikanët tanë turkoshakë tra-shëgojnë në rremba të gjithë bizantizmin e të moçmotëve, punojnë mbi udhë e nën udhë, kanë zellin dhe feçkat elegante të një urithi për t'iu hapur tunele poshtë vetes të tjerëve, troisin hanxharët e hakmarrjes dhe vënë dorën mbi bibël duke u betuar për shpirtin e tyre këndellës. Ata s'njohin ligje e rregulla, por fermene dhe urdhëra dhe vendime vetiake. pushtetin që iu kanë dhënë të tjerët, nga që s'e meritojnë, e shohin si diçka të rrallë e të çuditshme dhe ngrenë kokën nga qielli për të parë nga u erdhi kjo dhuratë e rrallë. Politikanët allaturka me kapele allafrenga në kokë s'kanë dinjitetin dhe vetiakësinë të kuptojnë se është turp të të kapin si fëmijë kopshti të huajt nga dora dhe të tregojnë tabelat në rrugën e demokracisë. Mbi parvazin e buzëve ata mbajnë si karafil të kuq një fjalë : reforma. Sigurisht, por reformat s'i bëjnë dot kapelet, por kokat...

Të rinjtë e Beratit : "Ku të argëtohem ?"

Një kalim i shpejtë përgjatë bulevardit kryesor të qytetit do të mjaftojë për të kuptuar se të rinjtë beratas çdo pasdite, të mbledhur grupe-grupe, bëhen pjesë e monotonisë që ka përfshirë prej vitesh qytetin e 16 mijë të papunëve. Ela, është një nxënëse që sapo ka përfunduar vitin e tretë? Në një prononcim për gazetën në lidhje me mënyrat se si mund të kalohet koha e lirë shprehet se është absurde të mendosh rreth këtij problemi në një qytet ku nuk ka as kinema, as disko apo vende të tjera dëfrimi. Ndërsa, përshëndetemi me të nëpër shkallët e bibliotekës janë ulur njëri pas tjetrit disa të rinj që këto ditë të nxehta ia kanë kushtuar përgatitjeve për konkurimet e shkollës së lartë. Duke adhuru arkitekturën ata ideojnë mbi letër ndërtime shumëkatëshe apo vepra arti, ndërsa, thonë se fati do t'iu ndihmojë për të fituar të drejtën e studimit, pasi, qyteti i tyre është shndërruar në një provincë. Pushimet e verës kanë sjellë në qytet qindra studentë që studiojnë brenda dhe jashtë vendit. "Përveçse mallit asgjë nuk më sjell në qytetin e Beratit", -thotë Iliri një student që ka vendosur të zgjedhë jetesën në Itali, pas diplomimit. Ai thotë se ditët në qytetin e tij të lindjes janë thuajse njësoj, nisin me pirjen e kafes dhe përfundojnë me një shëtitje në rrugët që bëhen të shkreta pas orës 22.00. Dori dhe shoqet e saj, që vitin tjetër do të jenë maturanter, shprehen gjithë mërzë për prishjen e lokalit të parapëlqyer pranë ish- kinemasë i quajtur "Pikolo grande amore", duke pohuar se në mjediset e tij ndiheshin vërtetë mirë pasi frekuentohej nga të rinjtë. Për të ngelur këtu do të ishte me vend pyetja se çfarë bëhet apo çfarë u afrohet të rinjve për kohën e lirë? E vetmja që afrohet pak veprimtari vazhdon të ngelet qëndra kulturore "AKS", ndërsa për institucionet e tjera të kulturës do të ishte mirë që mos t'iu përmendim fare, pasi dihet fare mirë që ata qëndrojnë larg të qenurit institucione kulturore madje, vetëm të tilla nuk mund të quhen. Ndërsa komunikon me të rinjtë për mënyrat që përdorin për të kaluar kohën e lirë, çuditëshe dhe ndihesh keq, kur mëson se po rritet një brez shumë larg librave. Djemtë e kanë zgjidhur këtë problem duke frekuentuar rëndom për orë të tëra bilardot dhe lokalet, ndërsa vajzat zgjedhin TV duke ndjekur telenovelat mëse mediokre. Ndërsa i pyet në janë më të mirat këto zgjedhje, ata ngrejnë supet duke pyetur: -Çfarë po na afrohet më tepër?!

Tregëtarët protestojnë Rriten orët pa energji elektrike.

Qytetarët i tremben kosumimit të ushqimit të përditshme

Ditëve të nxehta të këtij fillim muaji në qytetin e Beratit janë shtuar dhe orët e ndërprerjeve të energjisë elektrike. Në të gjitha lagjet e këtij qyteti energjia mungon për mëse gjashtë orë, ndonëse qytetarët e paguajnë në mbi 80% konsumimin e saj.

Energjia elektrike në këto ditë të nxehta vere mungon që nga ora 12.00 - 17.00 të pasdites. Përveçse pro-blemeve të panumërta që shkakton mungesa e energjisë elektrike në jetën e një qyteti, qytetarët i tremben konsumimit të ushqime-ve të përditshme. Janë dyqanet bulmetore dhe ato të mishit dhe nënprodukteve të tij që ndiejnë vështirësi në tregëtimin e artikujve. Pronarët e këtyre dyqanëve shprehen jo vetëm që ndihen në vështirësi për ushqimin e tregtisë, por, konsu-matori ka humbur dhe po humbet çdo ditë e më tepër besimin për konsumimin e artikujve që rrezikohen më tepër nga stina e nxehtë. Sipas tregtarëve mungesa e energjisë në këto ditë të nxehta vere është e paju-stifikueshme. “Gjatë ditës, ne, “shprehen ata detyrohemi ta mbajmë mallin në temperaturën e ngelur nga frigoriferët që nga nata dhe kjo na rrezikon shumë, pasi, qytetarët i tremben kësaj gjëje”. Ndërsa, disa dyqane e kanë zgjidhur këtë problem duke vënë në punë gjeneratorë, pjesa tjetër përballet me shqetësimin e drejtë të qytetarëve. Të njëjtin shqetësim ngrejnë dhe tregëtarët e pijeve freskuese, akulloreve etj. Për të njëjtin shkak vitin e kaluar kanë qënë të shumta rastet e sëmundjeve të papritura të qytetarëve nga konsu-mimi i ushqimeve të prishura madje, edhe këtë vit janë rregjistruar raste të tilla. Për këtë problem javën e kaluar rreth 50-tregtarë kanë protestuar në këtë qytet duke kërkuar përpara filialit elektrik të KESH-it, të irrituar, më tepër energji për të shpëtuar nga falimentimi bizneset e tyre. Ata janë shprehur se paguajnë çdo lloj detyrimi ndaj këtij filiali dhe përballet me orët e gjata të errësirës.

Biznesi beratas ende i rrezikuar *Maskat grabisin fabrikën e pijeve në periferi të qytetit*

Biznesi beratas ende ndihet i rrezikuar, ndonëse pretendohet se është vënë rendi dhe qetësia. Këtë rradhë ka qënë te fabrika e pijeve freskuese në periferi të qytetit që ka rënë pre e grabitjes me armë dhe maska. Ngjarja ka ndodhur mesnatën e ditës së premte në lagjen “Kombinat”, fabrika e pijeve freskuese me pronar Pëllumb Kalemin. Sipas dëshmitarëve okularë rojes së fabrikës, dhe punëtorit, kanë qënë tre persona të maskuar që kanë hyrë duke përdorur kërcënimin e armës në mjediset e fabrikës dhe kanë vjedhur rreth 5 milionë lekë që ndodheshin në kasafortën e fabrikës. Autorët janë larguar me shpejtësi nga vendngjarja, ndërsa policia ka bërë të ditur se ka ndaluar autorët dhe është vënë në ndjekje të tyre. Ndonëse maskat thuajse ishin harruar nga qytetarët beratas, ato i rikthehen duke tronditur biznesin e këtij qyteti. Ngjarja e ndodhur ka ngjadhur mjaft reagime tek biznesmenët beratas. Të pyetur në lidhje me këtë problem, drejtues të ndryshëm biznesesh shprehen se ndihen të rrezikuar. Vetëm disa muaj më parë një tregtar ambulant, ndërsa tregtonte në një fshat të këtij rrethi, bie pre maskave, të cilët nuk ngurojnë as të qëllojnë me breshëri armësh ndaj automjetit të tij. Ngjarje kjo që për fat të mirë përfundoi pa viktima. Të rrezikuara nga grabitjet kohët e fundit në këtë qytet kanë qënë dhe dyqanet. Vetëm gjatë një nate në qytezën e vogël të Urës Vajgurore janë grabitur dy dyqane me paisje celularësh dhe pjesë këmbimi. Vjedhjet e dyqaneve apo banesave nuk kanë munguar dhe në qytetin e Beratit, ku më të rrezikuara janë banesat e emigrantëve dhe dyqanet e pikave të shumicës. Mungesa e punësnë këtë qytet pjell pasiguri gjë që detyron drejtuesit e bizneseve t’i drejtohen qyteteve më të mëdha.

Përgatiti faqen: Eriola Azizolli

Vetvrasja , largimi fatal nga varfëria

Të drejtoshesh në farmacinë më të afërt me idenë fikse në kokë: për të blerë një helm apo një preparat të çfarëdoshëm për t’i dhënë fund jetës, kjo është zgjidhja e modës sot. Vetëm brenda 10-muajsh në rrethin tonë numërohen mbi 16 akte vetvrasjeje, pjesa më e madhe e të cilave kanë përfunduar me humbjen e jetës, ndërsa të pakta kanë qënë ato raste kur mjekët kanë shpëtuar nga kthetrat e vdekjes personat me “moral të ulët”, siç jemi mësuar t’i quajmë rëndom në jetën e përditshme. Ndonëse janë gratë (sipas statistikave) që janë më të prirura t’i japin fund jetës, rastet tregojnë se janë dhe burrat që shohin vetvrasjen si zgjidhjen e vetme përpara çdo vështirësie që u shfaqen. “Vuante nga depresioni nervor”, kështu komentohen përgjithsisht rastet e vetvrasjeve që kanë ndodhur në rrethin tonë gjatë këtij viti. Janë mbi 16 raste personash të moshave e sekseve të ndryshme që, për motive social - ekonomike, kryejnë aktin e vetvrasjes duke përdorur helme, armë zjarri apo litarë. Mjekët e qendrës spitalore të këtij qyteti shprehen se duhet të ndalet tregtimi i parekomandueshëm i helmeve apo preparateve bujqësore nëpër farmaci pasi ato përdoren si zgjidhje e shpejtë nga personat që vuajnë nga depresioni nervor. Rastet që kanë ndodhur njëri pas tjetrit brenda këtyre muajve kanë treguar se vetvrasjet janë shkaktuar kryesisht nga varfëria, që ka pllakosur familjet dhe nga problemet e tjera sociale. Vetëm një javë më parë, në një fshat të këtij rrethi, një 40 -vjeçar që kishte marrë para borxh për të ndërtuar një banesë dhe nuk mund t’i shlyente borxhin e marrë, vendosi t’i japë fund jetës duke u vetvarur. Ndërsa , po si pasojë e varfërisë, një 40-vjeçare nga fshati Levan, zgjedh Urën e Goricës për t’u flijuar. Një 16-vjeçare hidhet nga kalaja e qytetit. Të gjitha rastet e vetvrasjeve kanë treguar krizën e familjes, që thellohet nga dita në ditë, si rezultat i varfërisë, papunësisë apo pro-blemeve të tjera brenda saj.

Vetëhelmohet 15- vjeçarja 15-vjeçarja E.T, lindur e banuese në fshatin Goriçan, ka dashur t’i jap fund jetës,

Një tjetër rast vetëhelmimi është regjistruar në rrethin e Beratit. Pranë qendrës spitalore të këtij qyteti, ka mbërritur një vajzë 15-vjeçare e vetëhelmuar. 15-vjeçarja E.T, lindur e banuese në fshatin Goriçan, 21 km në perëndim të qytetit ka dashur t’i jap fund jetës, duke përdorur helm për brejtës. Adoleshentja ka përdorur preparatin në rrethana ende të paqarta, ndërsa ndodhej e vetme në dhomën e saj. Kanë qënë familjarët që, pasi kanë parë vajzën në gjendje tepër të rëndë shëndetësore, e kanë dërguar

menjëherë në spital. Burime nga reparti i urgjencës pranë qendrës spitalore bëjnë të ditur se, pas vizitës së kryer, është vënë re se vajza kishte marrë një sasi helmi që përdoret për brejtësit. Mjekët i kanë dhënë 15- vjeçares ndihmën e parë shëndetësore. Megjithatë ajo ende ndodhet në gjendje kritike për jetën. Policia e lajmëruar nga qendra spitalore ka nisur në vendngjarje , në fshatin Goriçan, grupin hetimor për të kryer hetimet e rastit. Nga hetimet e para mësohet se në dhomën e 15-vjeçares grupi hetimor ka gjetur në cilësinë e provës materiale sasinë e helmit të mbetur me të cilin vajza kishte kryer aktin e vetvrasjes. Ndonëse gjendja shëndetësore e vajzës vazhdon të jetë kritike, grupi hetimor ende nuk ka dalë me një version zyrtar në lidhje me motivin që e ka shtyrë vajzën t'i jepte fund jetës. Prindërit e 15-vjeçares janë shprehur se vajza e tyre sapo kishte përfunduar klasën e 8-të dhe nuk ka pasur asnjë shkak për të ndërmarrë këtë veprim. Ky është rasti i dytë brenda dy javëve të fundit që dy 15-vjeçare kanë tentuar t'i japin fund jetës, ndërsa është rasti i 16-të brenda 10-muajve.

Përgatiti faqen: Eriola Azizolli

Këshilltarët demokratë kundërshtojnë vendimet e fundit të Këshillit Bashkiak

Është zhvilluar paraditen e ditës së premte mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak. Në materialin e paraqitur për këshilltarët është kërkuar të miratohet fondi për dy objekte . Reabilitimi i fasadës në segmentin “Gjashtëkatësh -karburanti Eurodrin” dhe rikonstruksion rruge në lagjen “Uznovë”. Është miratuar vlera për reabilitimin e fasadave 3 milionë lekë në vlerë pjesore për vitin 2003 dhe për rikonstruksionin e rrugës në lagjen “Uznovë” vlera është miratuar 1 milion. Ndonëse këto fonde janë miratuar me vendim nr. 16, të datës 07.05.2003 në mbledhjen e miratimit të buxhetit të këtij viti, në materialin e paraqitur është theksuar se gjatë zbatimit të projekteve janë vërejtur disa pasaktësi. Kështu, është kërkuar që vlera e plotë pas tenderimit të kryer të shkojë në 7 milionë . Ky saktësim është kundër-shtuar nga këshilltarët demokratë, të cilët janë shprehur se miratimi i këtij vendimi që në të vërtetë nga ndryshim në vlerën e fondit është quajtur saktësim, është i padrejtë. Për këtë vendim ka pasur kundërshtime dhe nga këshilltarët socialistë.

Ka qenë këshilltarja dhe drejtoresha e arsimit Fatmira Mustafaraj, që është shprehur se duhet të jenë të gjithë të sinqertë për këtë vendim të miratuar më parë, nuk mund të pranohen më rritje fondesh. Ndonëse kjo pikë e rendit të ditës ka hasur kundërshtime, ajo është miratuar nga këshilltarët socialistë. Një pikë tjetër e rendit të ditës, në këtë mbledhje ka qenë aprovimi i disa titujve nderi, duke filluar nga “intelektualët e spikator” deri tek titulli “mjeshtër”. Në lidhje me këto aprovime titujsh, në një prononcim për gazetën, këshilltari demokrat Astrit Qafa u shpreh se ne si grup këshilltarësh e kundërshtuam këtë projekt. “Në përcaktimin e personave që do të fitojnë titujt”, shtoi z. Qafa, “mungon mendimi i komisionit të qytetarëve, apo komisioni i njerëzve të shquar. Mendoj se dhënia e titujve duhet të bëhet me konsensus nga të gjithë krahët politikë të përfaqësuar në Këshillin e Bashkisë.”

Duke filluar nga ky numër, do të botojmë pjesë nga antologjia “Poetë beratas në shekuj”, hartuar nga Agim

Mehqemeja, për t'i bërë të njohur lexuesit këtë pasuri pak ose aspak të njohur, ardhur që nga shekulli XVII. **Vështrim historik**

POETË BERATAS NË SHEKUJ Agim Mehqemeja

1

Poetëve beratas nuk ua pamë deri në ditët tona ngrehinën. Krijimet u mbetën të shpërndara. Vetëm disa zunë vend në antalogji ose në hapësirat studimore.

Me këtë botim po jua sjellim së toku që nga fillimet e njohura.

2

Berati i shekujve XVII-XVIII ishte një qendër e rëndësishme ekonomike, administrative e kulturore, me disa medrese, me biblioteka, me dijetarë e poetë të shumtë.

Në këtë mjedis lindi dhe u zhvillua letërsia shqipe me alfabet arab.

Autorë kryesorë të kësaj letërsie: Nezim Berati, Sulejman Naibi dhe Sulejman Temani, i nxori së pari në dritë në revistën “Zani i naltë” të viteve 1935 -1938 hulumtuesi i njohur beratas Abdullah Ferhati (1889-1939), i njohur me mbiemrin Telegrafi. Ishin shkrimet e tij që, më vonë, u shfrytëzuan dhe mbetën në themel të punës studimore të autorëve të historive të letërsisë shqiptare: Namik Resuli, Ziaudin Kodra, Dhimitër Shuteriqi, Osman Myderrizi, Sabri Hamiti, Robert Elsie...

Berati u bë kryeqendra e kësaj letërsie.

Në studimet e deritanishme, për rrethanat e kohës, jo me vlerësimin e duhur, kjo letërsi është quajtur letërsi e bejtexhinjve. Por, pa mëdyshje, mund të themi se ajo është pararendësja dhe guri mbi të cilin u mbështet dhe u ngrit letërsia e Rilindjes Kombëtare.

Këtë të vërtetë e zbulojnë veprat e përfaqësuesve kryesorë të Rilindjes Kombëtare, si dhe veprat e hartuesve të huaj të “Historisë së letërsisë shqiptare”.

Jo më kot, Sami Frashëri, në vitin 1882, përgatiti një përmbledhje me 27 poezi e 822 vargje nga divani i Nezim Beratit.

*Bënë emër Muçi Zade, Nezim Berati, Sulejman Naibi, Mulla Aliu, Solomoni, Mehmet Ashkiu-Ishkiu, Fejziu, Ismail pashë Velabishti, Sulejman Temani, Omer Sadedini dhe të tjerë më pak të njohur.

Këta poetë e dijetarë mbledheshin në vendshplohjet buzë Osumit, në mjediset e pazareve dhe në sallat e bibliotekave dhe, bashkë me diskutimet për probleme të diturisë, konkuronin dhe vinin në diskutim edhe krijimtarinë e tyre poetike, që shumë shpejt i kapërceu kufijtë e qytetit të tyre, Beratit, dhe me ndikimin e fuqishëm që pati, krijoi kushtet e lëvrimit të kësaj letërsie në rrafsh kombëtar.

*

Kjo letërsi, në Berat, dhe jo vetëm në Berat, pati dy drejtime kryesore:

Drejtimi i parë e mbajti krijimtarinë poetike disi larg gjuhës së popullit dhe më afër kulturës poetike të Lindjes. Fjalori poetik në krijimtarinë e këtyre poetëve është i ngarkuar me fjalë turke, persiane dhe arabe. Përfaqësuesi kryesor i këtij drejtimi është Nezim Berati.

Drejtimi i dytë e mbajti krijimtarinë poetike afër gjuhës së popullit. Kjo krijimtari, si më e kuptueshme, pati ndikim më të fuqishëm në këngën qytetare. Përfaqësuesi kryesor i këtij drejtimi është Sulejman Naibi.

Kjo letërsi u ndikua nga modelet letrare turke, persiane dhe arabe. U lëvruan marabeja, vjershë e gjatë lavdëruese; ilahija, himn fetar; kronogrami dhe epigrami.

Përmbledhjet poetike të kësaj letërsie u quajtën divane.

Njohim krijime nga Muçi Zade, Nezim Berati, Sulejman Naibi, Ismail pashë Velabishti, Omer Sadedini.

Na mungon krijimtaria e Mulla Aliut, Mehmet Ashkiut-Ishkiut, Fejziut, Solomonit, Nabiut, Zihniut...

*

Nga plaku Mulla Ali na ka mbetur vetëm historia e debatit poetik me Nezimin. Ky debat merr një domethënie të veçantë. Prandaj dhe duhet nënvizuar.

Kultura e gjerë dhe përmasat e një dijetari e ngritën Mulla Aliun në krye të udhëheqësit shpirtëror.

Debati me Nezimin i solli shumë probleme. Ai vazhdoi me vite dhe tërhoqi pas edhe simpatizantët e poetëve. Shehu, prej të cilit Mulla Aliu kishte marrë dorë, mbajti anën e Nezimit.

Nezimi për këtë debat në divanin e tij shkruan:

**Ç'faj ju paçë, o Mulla Ali,
pse ju mburra me nasihat, 1)
a ujdís t'i bëhesh asi 2)
shehut që ke marrë bejat? 3)**

Ndonjë kundërshtar, që nuk u bë i ditur, këtë debat ia bën të njohur Shej-ul-islamit 4) në Stamboll si një rast që kishte sjellë pështjellim në popull.

Pa hetime dhe pa kërkuar sqarime nga kadiu i Beratit, në korrik të vitit 1739, urdhërohet shkarkimi i Mulla Aliut:

I nderuari z. gjykatës i Beligradit shqiptar!

Mbas selamit ju bëjmë të ditur se myftiu i Beligradit shqiptar, Aliu,

është shkarkuar nga detyra e fetfasë 5), meqenëse jemi lajmërua që me sjelljet e këqija është duke shkaktuar anarkinë e qytetit. Duhet ta porositni me përsëritje që mbas sodi të rrijë në punë të vet e mos të përzihet më me çështjet e fetfasë.

Mulla Aliu hodhi dyshime mbi Nezimin.

Poeti i përgjigjet:

**Vetë ju thotë fakiri:
në ju paça faj, më mviri... 6)
O zemra ime, mos qaj,
se Nezimi nuk ka faj.**

Ky debat na kumton se shkrimi shqip me alfabet arab gëzonte emër që para Nezimit. Me të ishte zhvilluar jeta kulturore qytetare, ishte shkruar edhe poezia, që kishte arritur në ato nivele, sa të përdorej edhe në debate të artit poetik.

Vijon në faqen 7

POETË BERATAS NË SHEKUJ

Një zë i veçuar mbetet Kostandin Berati, me një poezi, përkthim i lirë nga greqishtja, shkruar me një alfabet të veçantë.

*

Një peshë të veçantë, që me shekullin XVII, ruan krijimtaria poetike në gjuhë të huaj. Krijon traditë, që vazhdon deri në fillimet e shekullit XX, poezia e mbishkrimeve.

Nga kjo krijimtari, me ndonjë përjashtim, kemi të shqipëruara vetëm mbishkrime në gurë varresh ose në objekte kulturi.

Në Berat dalin shumë poetë që e ushtruan këtë lloj poezie si profesion.

Janë të njohur: Nabiu, Mehmet Ashkiu-Ishkiu, Zihni, Hatifi, Hikmetiu, Irziu, Hilmiu, Sali Durdia dhe disa poetë anonimë...

E vlerësuam me interes përfshirjen e kësaj poezie në këtë përmbledhje të poetëve beratas. 7)

4

Poezinë e viteve të Rilindjes Kombëtare e gjejmë të shpërndarë në shtypin e kohës, ose e kemi të harruar në dorëshkrime që presin t'u hiqet pluhuri, nëse nuk kanë humbur.

Më e njohur u bë poezia e Jani Vruhos dhe e Sulo Resulit. Doli me poezi shqip edhe Nyzhet Vrioni, lindur rreth vitit 1879. 8) Një nga luftëtarët e shkollës shqipe, Islam Vrioni, krijoi shumë, por botoi pak. Ata që ia njohën krijimtarinë, i vlerësuan, sidomos, poezinë satirike. 9) Poet satirik, që improvizonte epigrame, ishte edhe Mehmet Ali Vrioni (1842-1895). Kjo krijimtari mbetet pak e njohur. 10)

Në këto vite, si një traditë në vazhdim, gjejmë edhe poezinë që u ngrit në këngë.

5

Në gjysmën e parë të shekullit XX, u bë i njohur, si një poet filozof me një zë të veçantë, Ferit Vokopola.

Më pas, nga mesi i shekullit, u veçuan katër poetë, që patën një krijimtari të ndërprerë: Jani Dodi, Kristaq Tutulani, Vexhi Buharaja, Namik Mehqemeja.

6

Rrethanat e kohës e ruajtën këtë ndërprerje. Vetëm në vitin 1969 u thye akulli.

Dolën me vëllime poetike: Agim Mehqemeja, Ramadan Pasmaçi, Llazar Fype, Astrit Nuri, Ylli Polovina, Simon Vrusho, Hajri Zogani, Mira Lino.

Vitet nëntëdhjetë do të merrnin për mbarë.

Dalin para lexuesit me botimet e sirtarëve: Pandeli Çina, Luan Myftiu, Lejla Mehqemeja.

Veçohen në këto vite: Nazif Agalliu, Yzedin Hima, Fatbardh Hoxha, Ilir Cenollari, Efti Mboqe dhe një brez, gjithnjë në rritje, të rinjsh të talentuar.

7

Në këtë ndërtesë poetike, poetët hyjnë në radhë sipas moshës.

Botimi nuk është gjithëpërfshirës.

1. Nasihat: këshillë.

2. Asi: i pabindur, rebel.

3. Bejat: marr dorë.

4. Shej-ul-islami: i pari fesë islame.

5. Fetfa: vendim juridik.

6. Mviri: varni.

7. Shqipërimet, në përgjithësi i kemi nga Vexhi Buharaja. Titujt e poezive nuk janë të autorëve.

8. Hysni Myzyri, "Shkollat e para kombëtare shqipe", Tiranë, 1973, faqe 172.

9. Vexhi Buharaja, "Kultura Islame", Tiranë, 1941, 23 -24.

10. Faik Konica, "Vepra 3", 2000, faqe 59.

Berat, 27 maj 2000

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Lejla Mehqemeja, kjo ëndërr e ndaluar

Yzedin Hima

Jam i sigurtë se Lejlanë e kanë pas dashuruar shumë burra në të ritë e saj. Se ajo që nga ato femra ku rrallë, tepër rrallë qëndrojnë bashkë edhe bukuria, edhe mençuria, edhe finesa, pra, ajo grua ishte një bukuri e bërë prej shpirti.

Po ajo ka qenë një ëndërr e ndaluar për burrat e hijshëm dhe të mençur të sërës së saj. Se ajo, për fat të keq, u rrit e vuajti në diktaturë (nuk mund të shprehem me fjalën jetoi, sepse do të fyeja mbijetesën e saj). Dhe familja e saj fisnike që ndër më të poshtëruarat pas vendosjes së diktaturës. Babai i saj, Izet Mehqemeja, u pushkatua nga nazistët në kampin e Majdanekut, në Poloni, si antifashist. Vëllai i saj, një bjond që shkruante poezi të ndjera, e denoncoi diktaturën komuniste ende pa u shtruar këmbëkryq në Shqipëri. Edhe ai u pushkatua po nga diktatura me ngjyrë të kuqe më 9 dhjetor 1945.

Tri motrat u lanë të vdesin ngadalë, të pambrojtura, në mjedisin e helmuar të luftës së klasave në Shqipërinë socialiste.

**“Hëna derdh shi të artë,
me dritë lan shpirtra të bardhë.
Kam ftohtë, s’kam gjumë ...**

.....

**Mendoj për jetën pa shpresë,
mëngjesin e zymtë që gdhin mbas pak”**

shkruan Lejlaja në një poezi të saj. Me ç’duket shpirtin e saj të dritë e ndritte vetëm hëna, netëve. Dita që dënim. Është një klithmë ekzistencialiste. Mëngjesi, pra, lindja është zymti, fyerje, poshtërim. Nata me hënë është ëndërrim, qetësi, prehje. Me ç’kuptohet moslindja, mosardhja në këtë jetë, do të që më e mira.

E kam njohur Lejlanë vite më parë, në librarinë e Shpresa Xhaferrit. Shpresa më prezantoi me Lejlanë, në një nga ato pasdite të dielash, ku libreria ishte i vetmi vend i shenjtë, (qenë ndaluar kisha e teqe). Lejlaja kishte vërtetë një vështrim të manushaqte, nuk e di në që thjesht iluzion nga emri i saj, nga flokët apo nga ngjyra e syve. (“Safo flokëmanushaqja”, do të

shkruante Alkeu 2600 vjet më parë.)

Herën e fundit qeshë për vizitë te Lejlaja së bashku me një tjetër grua të rrallë, Milikën. I kishte vdekur motra dhe e ngushëlluam. Ndenjëm më shumë se sa qëndrohet në raste të tilla, sikur ta parandjeja se nuk do ta takoja më.

Ajo, dhimbje e bukur, tronditet dhe nuk beson as bukurinë e saj kur shkruan:

**Dikush më dhuroi një lule të bardhë,
para pasqyrës e vura mbi flokë.
Ajo shndriti më shumë
nga lulja... apo nga unë ...?**

“Armiku” nuk lejohej të ishte as i bukur, as i mençur, sepse shkaktonte admirim nga gjindja, dhe ndoshta, në ndonjë shpirt ende të lirë, edhe dashuri dhe kjo do të trondiste rëndë luftën “e shenjtë” të klasave, skemat e socrealizmit për pamjen e mendjen e “armikut” të klasës.

Lejlaja, (herë-herë mendoj se fjalët kanë ngjyrë, dhimbja është e manushaqtë, pra, lejla), është e vetdijshme për këtë kur shkruan :

**Kur isha e vogël,
dhimbja ishte e madhe,
se mbaja dot mbi supet e njomë.
U rrita, u rrit edhe ajo me mua.**

Zot, i madh! Çfarë padrejtësie do të qe sikur shpirti i saj të mos ketë shkuar në parajsë!

Një intervistë që s’u dha

Xhevdet Dervishi e përmendte shpesh se vetëm unë e kisha mundësinë të flisja për të, nëse do të vinte ndonjë rast, meqë kishim patur një bashkëpunim krijues të gjatë, mbi 30- vjeçar, dhe i kisha në ruajtje të gjitha tekstet e këngëve të krijuara prej tij. Kur mora ftesën për koncertin që do të jepej më 3 korrik , me rastin e 60-vjetorit të tij, e mendova se kishte ardhur koha t’ia plotësoja këtë dëshirë.

Por, ata që e organizuan këtë koncert jubilar, edhe pse në program e përmendnin emrin tin si autor të tekstit të këngës “Çka ky zogu gushëbardhë”, kënduar nga Anxhela Saraçi, nuk e kishin parë të arsyeshme të kishin edhe emrin tim pranë dy të intervistuarëve, kryetarit të bashkisë, z. Nikollaq Mata, dhe një shoku të tij të viteve të shkollës.

E gjykova ta jepja në shtyp këtë intervistë të pashprehur në shenjë respekti për mikun tim Xhevdet Dervishi.

Xhevdetin e kam njohur që kur isha nxënës në shkollën pedagogjike, në vitet 1953-1954, dhe ai këngëtar i korit të ushtrimores, drejtuar nga mësuesi Sami Dakli.

Mbas mbarimit të studimeve, Xhevdeti u bë i njohur për të gjithë si studiues dhe përpunues i këngës popullore, si drejtues i bandës dhe si krijues këngësh të bukura.

Bashkëpunimin e nisëm që në vitin 1972.

Kemi krijuar së bashku 21 këngë. Janë fituar 6 çmime: një çmim i parë dhe 5 çmime të dyta.

Ndër këngët më të përzemërta ai ka patur: ”Gjyshi dhe pranvera” 1972, ”Buqeta e luleve” 1973, ”Dëbora e parë” 1973, ”Kur vjen vjeshta” 1973, ”Këngë dhe lule” 1974, ”Kush të pat mësuar” 1981, ”Çka ky zogu gushëbardhë” 2002...

Kur isha me nxënësit në Sheqeras të Maliqit, atje dëgjova të këndohej ”Këngë dhe lule”, një nga krijimet më të përhapura të Xhevdet Dervishit në ato vite.

Pesë vitet e fundit këngët i kemi ngritur mbi fabula, për të qenë më pranë botës së fëmijëve.

Shëndet Xhevdet Dervishi!

Të këndoftë pena siç të këndon zemra!

Agim Mehqemeja

Ekonomia e Beratit: në rrokullisje Ali Lybeshari

Këta tregues janë marrë nga statistikat zyrtare të qeverisjes vendore dhe janë të botuara në raportet statistikore të viteve përkatëse. Ja çfarë tregojnë këto raporte:

Ka rënë ndjeshëm numri i bizneseve private. Në fund të vitit 2002 në Berat operonin 304 subjekte private ose 19% më pak se sa në vitin 1996.

Në politikë jo e drejtë është ndjekur me shoqëritë e huaja. Nga 18 të tilla në vitin 1996, tani operojnë vetëm 4. Mjafton të kujtojmë se ndërmarrja e përbashkët shqiptaro-greke “Mika Berat” kishte mesatarisht 200 të punësuar dhe të paktën 2500-3000 ko-ntrata të përvitshme me fermerët privatë për prodhimin dhe grumbullimin e duhanit. Ka katër vjet që ajo është larguar nga Berati. Kështu ndodhi me Uzinën e baterive, me ndërmarrjen e prodhimit të shportave, etj etj. Në pozicionin ku

unë punoj, më duhet të analizoj situatën ekonomike të bizneseve të qytetit tonë, të cilët janë në rënie të pandërprerë. Mungesa 4-vjeçare e energjisë elektrike, rritja marra-mendëse e ngarkesës fiskale, konkurenca e pandershme, situatat-monopol të krijuara nga pushtetarët, të shoqëruara këto me rënien drastike të fuqisë blerëse të popullatës, kanë qënë faktorët kryesorë në këtë rënie. Inisiativa private në këto 6 vite nuk është financuar në asnjë rast nga shteti . Për 6 vjetët e fundit bankat apo institucionet e tjera shtetërore nuk kanë dhënë asnjë kredi për biznesin privat.

Produkti industrial i shitur në vitin 2002 ishte 7,3 herë më i ulët se sa ai i vitit 1996.

Që nga viti 1999 e në vazhdim mungojnë në statistikat zyrtare zërat më të rëndësishëm të këtij produkti, si duhan, miell, stofra e pëlhura etj. E vetmja industri që funksionon disi është ajo e blojes së drithit. Por të gjitha fabrikat, pa përjashtim, punojnë me grurë importi të blerë në Ukrainë. Fermeri beratas nuk sheh asnjë interes ekonomik të kultivojë drithin.

Volumi i punës në transport në fund të vitit 2002 ishte 4,9 herë më i ulët në krahasim me vitin 1996.

* Niveli i investimeve private e publike në vlerë në fund të vitit 2002 ishte 1,6 herë më i ulët se sa niveli i tyre në vitin 1996, ndërsa për 5 vitet e fundit, vlera e investimeve publike e private ka qënë mesatarisht 2 herë më e ulët se sa vlera e tyre në vitin 1996.

Numri i lejeve të ndërtimit të dhëna gjatë vitit 1996 ishte 2,6 herë më i lartë se numri i këtyre lejeve të akorduara gjatë vitit 2002, dhe 9% më i lartë se numri i lejeve të ndërtimit të dhëna në 5 vitet e fundit të marra së bashku. Kjo do të thotë se dëshira e qytetarëve beratas për të ndërtuar e investuar këtu dalëngadalë po vdes. E kjo është shumë e dhimbshme.

Vetë shteti detyrohet të pranojë shtimin e papunësisë dhe rritjen e varfërisë.

Numri i të punësuarve në sektorin publik e atë privat në vitin 2002 ka qënë 47% më i ulët se numri i të punësuarve në vitin 1996, ndërsa në pesë vitet e fundit zënia me punë e fuqisë punëtore ka rënë mesatarisht me 9,5% në vit.

Numri familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike në vitin 2002 (familjet që jetojnë nën minimumin jetik), është 2 herë më i lartë se numri i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike në vitin 1996.

E thënë ndryshe, numri i familjeve që jetojnë nën minimumin jetik në vitin 2002 përbën 32% të numrit total të familjeve, nga 14% që përbënte në vitin 1996.

Të gjithë këta tregues formalizojnë zyrtarisht atë që të gjithë ne e shohim për ditë: përkeqësimin gjithnjë e më shumë të gjendjes ekonomike të qytetit e të rrethit tonë. Dukuria më gërruese është “emigrimi i trurit”. Në Berat kjo dukuri ka marrë përmasa të papara . Do ta ilustruj me dy- tre shembuj shembuj:

1. Në pesë vitet e fundit, ka qënë mbi 30 numri i studentëve beratas që kanë përfunduar studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës me notë mesatare mbi 8-të. Por, a e dini? ... Vetëm 4 prej tyre janë kthyer në Berat. Të tjerët ose janë vendosur në Tiranë (dhe në rrethe të tjera), ose kanë emigruar jashtë Shqipërisë. Nuk kam ndonjë informacion të saktë, por e njëjta situatë vihet re edhe për studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit, Juridikut, Punës Sociale, etj.

2. Të gjithë studentët e Beratit që kanë studiuar jashtë shtetit nuk janë kthyer në Berat.

3. Ndërtuesit, inxhinierët dhe arkitektët e talentuar të qytetit tonë që me punën dhe dijet e tyre kanë projektuar vepra të mrekullueshme në këtë qytet, ose kanë mbyllur bizneset e tyre, ose i kanë shpërngulur ato në qytete të tjera, ose janë larguar nga Shqipëria. Nuk jam munduar të numëroj mjekët, ekonomistët, teknologët, mate-maticienët, gjuhëtarët etj, etj, sepse lista e të ikurve do orë të lexohet.

Ja, pra, në ç’situatë gjendet ky qytet. Truri i tij, talentet e tij të provuar ikin, ikin, ndërsa ata që përgatiten për t’u bërë talente nuk kthehen më këtu. Kush do ta bëjë pra Beratit? Shpresoj tek një politikë ndryshe, tek një shtet ndryshe dhe tek një qeverisje ndryshe nga kjo e sotmja. Për t’ia arritur kësaj nevojitet, së pari, frenimi i rrjedhjes së trurit dhe, së dyti, angazhimi i tij për të marrë në dorë fatet e vendit.

Venera Protopapa

Midis meje dhe diellit

Lindi në Berat në vitin 1986. Mbaroi vitin e tretë në Shkollën e Mesme të Përgjithshme “Kristaq Capo”. Në konkursin artistik “Spring 2003”, organizuar me të rinjtë e qytetit të Beratit, nga biblioteka “Vexhi Buharaja”, zuri vendin e parë. Staf i gazetës “Lajmëtari” i uron Venerës suksese në fushën e krijimtarisë poetike.

Udhë që s' do të shkelet më ...

Zvarritje mbi pentagrame të përgjakur
mbetur shkretë nga arratisja e notave

dhimbje, një këputje e thatë në shpirt

flakëritje e syve mbi mur

tablo mesjetare e pistë dhe misterioze

frikë dhe ngushti
frymëmarrje që lind
nga këputja e fjalës në grykë
dhe jetë që lind prej hirit të vdekjes
mbi buzë dhe një pikë gjak e lot ...
Jo më të lutemi nga fillimi, jo më ...

Sot vendosa të mos jem me nder të humbur ...

Sot vendosa të mos jem me nder të humbur

sikur të kish qënë vullneti im

shkaku i mijëra humbjeve

Sot vendosa të mos jem më e humbur

sikur të qe e lehtë

të vrisja humbjen time

Sot, unë vendosa të mos jem me nder të humbur

pa menduar se ndoshta

është fati im të jem e humbur

Sot, po sot vendosa të mos jem me nder të humbur

sikur të mund të harroja

përbuzjen e mijëra të fituarve

Sot vendosa të mos jem më vetvetja

Nuk e di sa do të zgjasë

por di që nuk do të jem

kurrë e lumtur në heshtjen time...

Ne të dy

Ne të dy,

shtrijmë duart

dhe prekim dejet e njëri- tjetrit,

mbyll sytë

dhe ndiej

gjakun tim në venat e tua

dhe ti padashur

ndien shijen

e pikës së lotit mbi buzët e mia

Ne të dy,

prekje që shndërrohet në cikje,

në lëkurën e njëri - tjetrit
dhe prapë vetvetja

Midis meje dhe diellit

Ka gjëra që ia them

vetëm diellit në perëndim

dhe dhimbja ime

tretet në dhimbjen e valës për diellin

Ka gjëra që ia them

vetëm diellit në perëndim

dhe gjakun që më rrjedh syve

e fsheh përflakja e detit,

ulërimën time

e mbyt britma e natyrë për birin.

Ka gjëra që ia them

vetëm diellit në perëndim

dhe fle e qetë

se nuk di gjë nata.

Sa herë më merr

mali për veten

rikthehem tek dielli ...

Lumturi e hidhur

Shkronja që s' thuriten prej fjalës

për t' u mbledhur me mijra lëmshenj

që mblidhen në grykë

dhe më mbysin fjalën

Harresë që mbështjell shpirtin

dhe më rrëmben ditën

unë humbur kujtesën në natën e gjatë

Lajthitje që tingëllon ëmbël

mbi pianon pa nota

dhe duar që lëvizin kuturu

në hapësirën pa tastierë.

Trupa,

njëri mbytur në lotët e tjetrit.

Hijes sime ...

Humnerave të mia

zhvarrosa heshtjen e vjetër

që shumë i kish munguar

të zezës hijes time

dhe tej flakërita frymën

që shumë e kish lodhur

të zezës hijen time

Humnerave të mia

lashë lëkurën e zhveshur

që sa nuk po e mbyste

të zezën hijen time.

Botohet me rastin e 7 korrikut, 60-vjetorit të vrasjes së saj së bashku me të vëllanë, Kristaqin, pas një tradhtie, mbetur e dyshimtë, nga fashistët italianë.

Margaritës

Zbardhi shpata,... u nxi dita,
ra një trup,... u ngrit një emër,
ra dëshmore Margarita:
doli burri nga një femër.

Rëndoi dora italiane
mbi një vashë zermër-djali,
mbylli jetën kjo Titane
për t' u çelur ideali.

Vdekjen afër duke parë,
"Qeshu jetë!- zu të thotë,-
për lirinë, që, duke qarë
e kërkove nëpër botë!"

Pse po qan nënoja vallë?!
Për të rrojtur vdiq një femër,
u shua plumbi mu në ballë,
ndezi ylli mu në zemër...

Më i thellë se nga deti,
më e fort' se rreze e dritës,
më lëkundës se tërmeti
është zëri i Margaritës.

Nëno, moj, pusho ti lotin!
Nuk ka vdekur ndënë dhetë,
është gjallë, moj, për Zotin,
po shkrep zjarre përmbi retë.

Vexhi Buharaja

Ajet Nallbani

Zhvillimi urbanistik dhe arkitektonik i Beratit në shekujt XIX-XX

Shekulli XX e gjen Beratin një nga qytetet më të zhvilluara në drejtimin urban, ekonomik dhe kulturor, si rezultat i asaj trashëgimie prurë nga shekujt XVII-XVIII, kur qyteti shquhej si kryeqendër.

Edhe pse qytetet shqiptare gjatë shekullit fillojnë të kenë një hop të dukshëm në fushën e ndërtimeve dhe të urbanistikës, në Berat vihen re hapa më të ngadalshëm. Ishte një qendër tjetër që merr zhvillim dhe i del në rrugë. Ky qytet ishte Janina. Aty formohet një nga pashallëqet më ambicioze, për të cilin Porta e Lartë përqendron vëmendjen kryesore.

Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror që mori Janina, bëri që tregtia të zhvillohet më tepër në këtë drejtim, duke mënjanuar, në një farë mase, ndikimet e qytetit të Beratit, që sollën edhe një frenim në zhvillimin e mëtejshëm urbanistik dhe në fushën e ndërtimeve të tij.

Edhe pse Berati nuk po ecte me hapat e qyteteve që po imitonin ndërtimet dhe arkitekturën evropiane, ndihej ndikimi i tyre në vendosjen me delikatesë në banesat ekzistuese të mjaft elementëve të rinj që e bëjnë të dallohet nga qytetet si Tirana, Elbasani, Korça, etj. Zgjerimi i qytetit në zonat e lira zhvillohet përgjithësisht sipas këtyre ndikimeve, duke u karakterizuar nga vazhdimësia e traditës së mëparshme pasuruar me elementë të rinj.

Ndërtimet e trashëguara nuk u prekën në volumet e tyre. Për efekte të arkitekturës së re si dhe për nevojat e zgjerimit të trungut familjar u bënë vetëm mbyllje të mjediseve të hapura duke krijuar kështu mjedise të reja brenda së njëjtës sipërfaqe dhe volumeve të banesës së hershme. Fasadat e këtyre banesave patën një trajtim që përshtatej me teknikën e re ku elementë bazë u bënë strukturat prej druri.

Këto ndryshime filluan që nga gjysma e dytë e shekullit XIX, pas shkatërrimit të madh të qytetit nga tërmeti i vitit 1851. Në katet e sipërme të banesave, zëve-ndësohet ndërtimi i mureve të gurtë me çatma, si një material i qëndrueshëm ndaj lëkundjeve sizmike, që ndërtohej shpejt, duke plotësuar kështu nevojat e strehimit të shkaktuara nga tërmeti.

Elementi drusor gjendej në periferi të qytetit dhe transportohej relativisht më lehtë se materiet e traditës të deriatëhershme. Ky rikontsrksion pati efekte të mëdha në elementet e arkitekturës si në pjesën e brendshme të banesës, ashtu dhe në pamjen e jashtme të saj, duke i dhënë atë pamje që ne e shohim deri në ditët tona. U futën gjerësisht në pajisjet e banesave dekorimet me motive të gdhendura në dru dhe allçi, mobilimi i odave, sidomos ajo e miqve, që bëhet mjaft e pasur në këtë periudhë.

Një element i futur që në shekullin XIX dhe që vazhdoi si i tillë dhe në fillimet e shekullit XX ishte qoshku. Ky element ndërtohej në mjedisin e çardakut, ishte më i ngritur, me parrakë të gdhendur, i mbuluar me strehë për t'u mbrojtur nga shiu dhe dielli, i shtruar me shilte ose flokje, ku familjarët ose bujtësit kalonin kohën e lirë duke pirë kafe shoqëruar me duhanin thithur me nargjile. Ky mjedis tepër intim ka zenë vend edhe në këngën popullore:

**Qoshk, o i bukuri qoshk,
rëntë e bukura përposh,
rëntë e theftë këmbën e gjunë,
doktorbash iu bëfsha unë!**

Një element tjetër në ndërtimet me çatma të kësaj periudhe janë edhe daljet me erker, të cilat veç rritjes së sipërfaqes së banimit, kishin edhe efekte arkitektonike. Këto dalje në shumicën e rasteve ishin si mbikalime mbi rrugicat e ngushta për të mos pengua kalimin. Ky element shumë i larmishëm e bën Beratin një mrekulli për syrin dhe penelin e artistit.

Nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX në Berat shfaqet si element i ri ndërtimor kulla, që shpesh quhet edhe kulla. Ky mjedis ndërtohet mbi kulmin e çatisë, rreth 10 metër katror, me përmasat dhe lartësinë e një kati. Ngjitja për në kulë bëhej me shkallë druri nga mjedisi i korridorit dhe, ndonjëherë, nga mjedise të tjera. Shkallët ishin të thjeshta dhe të ngushta. Ky mjedis ishte me dritare të shumta të drejtuara nga qendra e lagjes, ku dhe kishte më tepër fushëpamje. Dritaret mbylleshin me kafaze, sepse ky mjedis shërbente më shumë për vajzat e reja, të cilat kalonin aty kohën e lirë me shoqet apo farefisnin dhe qendrisnin pajën.

Ky element është i pranishëm në banesat e Beratit. Ndërtohej, sidomos, në ato lagje që kishin pamje të kufizuara, prandaj i gjemë më tepër në "Murat Çelepi" dhe Vakëf. Edhe kulat kanë bërë vend në këngën popullore:

**N'ato kula n'ato penxhere
hyjnë e dalin dy melaqe,
flasin bejte ashiqare...**

Këto elemente, si shtesa të arkitekturës, e bëjnë Beratit një qytet të papërsëritshëm. Tipologjinë e banesës beratase e ka trajtuar studiuesi i njohur, profesor Emin Riza, që nga më e hershëmja me mure guri, e ndërtuar përpjendikular me terrenin, me kate të plotë apo me gjysmëkati, deri tek ato me zhvillim horizontal, me çardak në mes apo anash. Në fillimet e shekullit XX edhe në Berat vihen re ndërtime banesash të veçanta jashtë traditës, me vëllime të ndryshme dhe me 2-3 kate. Ndonjëherë këto lloj ndërtimesh janë futur brenda ansambleve karakteristike të qytetit. Ato përkohë me periudhën e zbritjes së administratës vendore nga Kalaja në qendër të qytetit. Midis këtyre ndërtimeve përmendim ndërtesën e pre-fekturës, të gjykatës, një sërë dyqanesh, si ai i Novës, i Nushit, Qafokut, Kosovës. Ndërtime bashkë-kohore janë bërë edhe në mjediset e lagjave. Midis tyre përmendim atë të garnizonit turk në lagjen "Murat Çelepi", ish-shkolla fillore. Këto ndërtime të reja nuk e konkurojnë dot atë arkitekturë masive të trashëguar. Ato u përhtatën duke mbajtur vulën e kohës. Interesant është edhe zhvillimi urbanistik i qendrës së qytetit në fillimet e shekullit XX. Nga një planimetri anonime, punë e mirëfilltë e një intelektualit, kemi të dhëna për vendosjen e objekteve sociale, të banjave, çezmave, puseve, faltoreve. E mendoj një punë të Shyqyri Lakrës, i cili në kujtimet e tij i prek të gjitha këto objekte. Autori midis rrugëve, të cilat i kemi nxjerrë edhe nga kufizimet e disa tapive të vjetra, përmend: rruga "Mbret", "Durhan", e Kujunxhinjve, e Xhokaxhinjve, si dhe disa pika orientimi: "Aty ku dridhen qerret", "Tek undra", "Tek mulliri", "Tek banjat", "Tek Delibega", "Tek arrët e Pashait", "Tek ura me zinxhira" (kështu quhej Ura e Goricës, dëmtuar gjatë Luftës së parë Botërore dhe rikonstruktuar me elementë metalikë deri të ribërjen e saj në vitin 1927 nga bashkia).

Në ferr dhe në parajsë jemi me një fe

4 korrik 2003

Sot m'u dha rasti të shëtis Beratit me dy personalitete të artit dhe të kulturës nga Parisi. Me piktorin Omer Kaleshin, filozofin, humanistin, shkrimtarin, përkthyesin, mitologun francez Jacques Lacarriere.

Është shumë e rëndësishme të kalosh disa orë me njerëz të tillë, në këtë zbrazi, në këtë kohë, kur të ditur janë një specie e rrallë. Duke mos u zgjatur, po ju njoh me ta:

Cili është Omer Kaleshi? Po citoj Ismail Kadarenë dhe Alain Bosquet.

Kadare:

Bosquet:

* Qëllimi i tij:

"Të njihet me njerëzit, të zbulojë vlerat e tyre"

"Përse persët dhe grekët luftuan kundër njëri-tjetrit? Sepse nuk njiheshin si duhej."

Në momentin e largimit më premtoi: "Në dimër do të dërgoj shënimet e mia për Beratit"

Po përshkruaj thjeshtë vizitën e tyre:

Gjithçka nisi në Galerinë e Arteve "Eduard Lear"

Omer Kaleshi : "Kastriot, dëgjo çfarë thotë Lacarriere se është boll i ditur. (Me të folurën e tij të thjeshtë dhe në dukje naive). Vëzhgonte me vëmendje, herë largohej herë afrohej. Megjithatë unë kisha më tepër interes të bisedoja me Kaleshin.

E drejtova te pikturat e mira që t'ia tregoja. "Por, çuditërisht, ai kishte një kujtesë të jashtë-zakonshme.

"Kastriot, ajo është piktura jote." U habita. Si ka mundësi në një takim të shkurtër 5 minuta para dy vjetësh të kujtojë çdo gjë.

U larguam nga Galeria dhe vizituam Xhaminë Mbret, ditë e premtë, ora 12.00. Disa besimtarë po kryenin ritet e ditës së mirë. Më pas shkuam në Teqenë e helveticë për të shijuar tavanin e jashtëzakonshëm. Më pas iu drejtua Kalasë dhe pikërisht në Muzeun "Onufri" e më pas në kishën e Shën Vllahernës, Shën Kollit, dhe Konstandinit dhe Helenës.

Roja i kishës së Shën Vllahernës, pasi hapi derën dhe, për t'u treguar xhentil, tha: "Këto janë ikona". Të them të drejtën e nxora me arrogancë jashtë që të na linte të qetë, sepse e ndjeva se do të fillonte shpjegimet e tij ashtu si shoferat e shefave, ministrave, drejtorëve, deputetëve, etj... I thashë z. Lacarriere se këtë kishë e kishte pikturuar i biri i Onufrit, Nikolla.

"Po, Onufri e kam parë për herë të parë në Malin Athos në Greqi - m'u përgjegj. "Ju këtu mund të shikoni figurat e shenjtorëve të pikturuar nga Shenjt Onufri" dhe filloi të më tregojë për të:

Që nga ky moment fillova t'i kushtoj shumë interes çdo bisede me të. Gjatë drekës i bëra disa pyetje z. Lacarriere dhe zotit Kaleshi.

Dua të di pas kësaj vizite të shkurtër dhe intensive por të lodhshme për një 78- vjeçar, pasi udhëtua gjatë gjithë kohës në këmbë, mendimin tuaj për Beratit?

"Është shumë e rrallë të shikosh kisha dhe xhami së bashku, as në Lindjen e Mesme nuk i kam parë. Ajo që ngacmoi më tepër në Shqipëri ishte vizita në varrezat e Sharrës në Tiranë... e jashtë-zakonshme! Së bashku muslimanë, ortodoksë, katolikë, bektashinj. Mendoj edhe në Berat kështu është. Dhe në do ta dish më thellë mendimin tim, ne sapo vdesim nuk kemi më fe ose e thënë ndryshe në

ferr dhe në parajsë jemi me një fe.”

Ajo që më intereson me tepër është fusha e Arteve Vizive, pasi ju jeni një kritik arti?

“Në fushën religjioze ju keni tre katër zëra, ndërsa në pikturë ka shumë zëra, por që mendoj se janë të gjithë të influencuar nga piktura europiane. Ajo që është e rëndësishme për artistët e Beratit është se nuk duhet të jenë spektakolarë, por duhet të jenë më vendas, ashtu siç bënte MATISE, i cili pikturoi diellin francez edhe ju duhet të jeni si arkitektura, fryma, jeta e qytetit.”

Ndërsa Kaleshi u shpreh: “ *Sa herë që vij në Berat mrekullohem nga Onufri dhe Shpataraku, Ikonat e Onufrit i ndiej shumë.*

Kastriot Dervishi “*Është vështirë të dallosh ku është kufiri i identitetit shqiptar të Omer Kaleshit, me identitetin e tij turk, apo njerëzor në përgjithësi. Vizioni i tij rend i lirë dhe i natyrshëm nga Alpet e bardha shqiptare në stepat e Anadollit dhe më larg. Tragjizmi i këtij piktori ka brenda një kumt profetik...*” Shpesh, pothuaj gjithnjë, kokat e pikturuara të Omer Kaleshit janë koka të ndara nga trupi, i cili jepet vetëm në mënyrë aluzive, që nënkuptohet . Koka qëndron më vete. Ajo nuk ka nevojë për pjesë ndihmëse, d.m.th të trupit që i përket, por që tashmë refuzon t’i përkasë. Ai mund të matet me fytyrat e stuhishme dhe klithëse të Francis Bacon.

Omer Kaleshi

Nga Kërçova e Maqedonisë, piktori i shquar shqiptar, studioi në Stamboll. Jeton në Paris. Hera e tretë që viziton Beratin.**Jacques Lacarriere**

Lindi në 1925 në Limozh të Francës. Jeton në Paris. Filozof, Romancier, Përkthyes, Mitolog, Kritik Arti.“ONU-FER do të thotë Bariu i Buajve.

Onufër - Shenjt i shkretëtirës që i përket qytetërimit kopt të krishterë të Egjiptit i cili jetoi dyzet vjet lakuriq dhe mjekra e tij e gjatë i mbulonte seksin. Më pas përqafoi ortodoksinë dhe është shenjt i saj.”

Mediakafe

Berati qe zbukuruar për festë. Ishte fundi i Majit. Në sheshin kryesor qenë

mbleshur dhjetra e dhjetra njerëz. Pushtetarët lokalë kishin veshur kostumet më të bukur. Banda frymore qe rreshtuar përballë diellit dhe veglat e tunxhit shndritnin.

- Erdhën! Erdhën! - thirri dikush. Turma u tendos. Dirigjenti lëvizi krahët në ajër. Nisi marshi festiv. Pas disa minutash, turma u shtendos. Makinat nuk po dukeshin. Çfarë kishte ndodhur?! Përgjegjësi i ceremonive të Bashkisë vrapoi drejt fundit të shëtitorës. Atje pa makinat me targë CD që kishin ndaluar. Përfaqësuesit e trupit diplomatik, të veshur sportiv e me fëmijët kalikëç qenë ulur në barin e lulishtes. Një nga përkthyesit e tyre pyeti përgjegjësin e ceremonive: - Çfarë po ndodh tek sheshi? Ka ardhur ndonjë president apo ndonjë kryeministër i vendeve mike?!

-Jo,- u përgjigj përgjegjësi i ceremonive. Nuk ka ardhur as Presidenti i Italisë, as Kryeministri i Greqisë. Po ju presim juve. Diplomtatë panë njëri-tjetrin të lemerisur .

Në Galerinë e Artit qe hapur një ekspozitë pikturë. Merrte pjesë Ministrja e Kulturës. Në koktejl iu afrua Koçua, që kishte hedhur ca gota.

- Gëzuar! Më je kinge më je, !

-Me kë kam nderin të takohem? - pyeti Ministrja paksa e habitur.- Me ndonjë militant të partisë?

-Jo! Ke nderin të takohesh me Koçon, portieri rezervë të Pallatit të Kulturës.

Në një prag feste qenë mbledhur krerët lokalë për të ndarë punët që festa të dilte sa më e mirë.

- Unë kam kumtesat - tha njëri

-Unë kam ftesat - tha tjetri.

- Ndërsa unë kam gazet. - tha pushtetari më i shkurtër i Beratit.

- Unë, si gjithmonë kam mëngjezin, drekën, iqindinë dhe darkën, - foli pushtetari më kaba i Qarkut.

Në një takim të Partisë opozitare në vitin 1991, hyri në sallën e mbushur plot një burrë i shkurtër, më tepër i gjerë se sa i gjatë. Kërkoj vetëm një minutë qetësi se do të pyeste për diçka. Salla dalëngadalë heshti.

- Më falni , dini gjë se kush i jep ato vërtetime që je demokrat? - pyeti rrampaduci.

E gjithë salla u shkri gazit, ndërsa burri shihte serioz, me sy demi në drejtim të sallës.

Pas dymbëdhjetë vjetësh reportieja e gazetës sonë na njoftoi se vërtetimin që je intelektual i spikatur i qytetit e jep Këshilli i Bashkisë Berat, me propozim të Drejtorisë së kulturës në Bashki.

Foto arkiv

nga Vlash Pambuku

Ishte traditë në vitet 1948 - 1965 që në manifestimet e ditës së "1 Majit" të parakalonin edhe ekipet sportive të sporteve të ndryshme.

Në foto janë duke parakaluar çiklistët, njëkohësisht edhe dyqanxhinj të dhënies me qera të biçikletave.

Në foto pjesmarrësnë veproimtaritë lokale të biçikletave: Xhemil Hoxha i pari majtas ka drejtuar edhe ekipin e çiklistëve të vegjël. Ai, u ka dhënë ndihmesë të vazhdueshme dhe pa shpërblim, ekipit të çiklistëve "Tomorri" dhe çiklistëve të klubeve të tjera që vinin në Berat gjatë rrethit çiklistik të Shqipërisë

Në foto : Xhemil Hoxha, Karaman Gjeoroveni, Muharrem Kafazi, Vangjel Prifti...

Në vitin 1938 në shkollën e mesme të qytetit u ngrit grupi i valleve dhe i lojërave popullore. Ky grup në lojërat popullore që u zhvilluan në kinema "Nacional" luajti lojën " 7 ngjyrat e ylberit", përgatitur nga mësuesja Eleni Stefa.

Në foto : Grupi lojërave popullore 1942

Lart: Tefta Sallabanda, Olimbi Tavanxhi, Hatixhe Sollaku, Tefta Laro, Margarita Tavanxhi, Zoica Capo, Marie Kosova, Vangjeli Prifti, Efterpi Vrahoriti.